

DEKLARATE PELQIMI

Unë i nënshkruari _____ datëlindje _____, i identifikuar me dokument Identifikimi _____, madhor/e, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, *me cilësinë time si:*

- Klient i Bankes

- Perfaqesues Ligjor i Subjektit _____

- Person Kontrollues _____

(Ju lutem perzgjidhni cilesine qe mbani. Mund te perzgjidhni me shume se nje alternative)

DEKLAROJ dhe shpreh **PËLQIMIN TIM** për përpunimin e informacionit financiar dhe të dhënat e mia personale nga Banka si më poshtë si vijon:

1. Deklaroj se të gjitha informacionet e dhëna nga banka ProCredit nga unë janë të sakta dhe të vërteta, dhe unë pajtohem që të dhënat e mia personale të deklaruara në ProCredit bankë në momentin e regjistrimit dhe gjatë marrëdhënies sime me bankën, të përpunohen në kuadër të kujdesit të duhur për CRS dhe në përputhje me kornizën ligjore dhe akte nënligjore në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sekretin bankar dhe sekretin profesional.
2. Autorizoj ProCredit Bank, për arsye të kryerjes së kujdesit të duhur në kuadër të detyrimeve të CRS dhe vlerësimit të statusit tim, për të verifikuar saktësinë dhe tërësinë e informacionit të dhënë nga unë, që të shkëmbejë këtë informacion me Autoritetet Kombëtare Fiskale dhe me Autoritetet Tatimore të vendeve të tjera, në të cilat unë si klient individual i bankës; përfaqësues ligjor i ndonjë subjekti tregtar ose si person kontrollues mund të jem rezident i taksave në përputhje me kornizën ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sekretin bankar dhe sekretin profesional.
3. Unë autorizoj me vullnetin tim të lirë dhe të plotë Bankën ProCredit, të përpunojë, transferojë dhe trajtojë të gjitha të dhënat e mia personale dhe financiare të deklaruara nga unë, të tanishme apo të ardhshme, tek Autoritetet Kombëtare Fiskale. Këto të fundit mund t'i kalojnë të dhënat dhe tek Autoritetet Tatimore të vendeve të tjera, në të cilat unë si klient individual i bankës; përfaqësues ligjor i ndonjë subjekti tregtar ose si person kontrollues mund të jem rezident i taksave në përputhje me Standardet CRS, kuadrin ligjor kombëtar dhe aktet nënligjore në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sekretin bankar dhe sekretin profesional.

Banka raporton tek Autoriteti Fiskal Kombëtar informacionin e llogarive financiare, si dhe të dhënat personale të mbajtësit të llogarisë (individë, persona kontrollues, subjekt tregtar). Disa nga këto të dhëna të raportueshme janë: Emri; Adresa; Juridiksioni (et) i vendbanimit; Numri (t) i identifikimit tatimor (TIN); data dhe vendi i lindjes (për personat individë); numri (at) i llogarisë për llogaritë rrjedhëse, llogarite e kursimit, Depozitat, etj; gjendjet ose vlerat e llogarisë deri në fund të vitit kalendarik ose ne datën e mbylljes së llogarisë; shumën totale bruto të të ardhurave, dividendët ose të ardhurat e tjera të krijuara në lidhje me aktivet e mbajtura në llogari, si dhe të ardhurat totale bruto nga shitja ose riblerja e aktiveve financiare, në secilin rast të paguar ose të kredituar në llogari gjatë vitit kalendarik ose periudhe tjetër e raportimit
Në rastin e njërive, personave kontrollues të entitetit, të identifikuar në përputhje me dispozitat e CRS / Ligjit dhe akteve të tjera nënligjore: Emri; Adresa; Juridiksioni (et) i vendbanimit; Numri (et) i identifikimit tatimor (TIN); data dhe vendi i lindjes.



Të dhënat e plota dhe të sakta të cilat do të raportohen nga Banka tek Autoritetet Kombëtare Fiskale (Drejtoria e Përgjithshme e Tatimes) gjenden dhe janë në përputhje me Ligjin "Për Shkëmbimin automatik të informacionit për kontabilitetin financiar" dhe akte të tjera nënligjore.

4. Në rastet kur banka ProCredit konsideron të kontraktojë palë të treta, kompani të tjera për të arritur qëllimin e zbatimit të CRS, unë jap pëlqimin tim për përpunimin nga këto kompani të të dhënave të mia të deklaruara në ProCredit bank, në funksion të zbatimit të CRS.
5. ProCredit Bank më garanton se janë marrë të gjitha masat për trajtimin e sigurtë të të dhënave personale dhe financiare të mia si subjekt i CRS, në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sekretin bankar dhe profesional.
6. Kjo Deklaratë Pëlqimi do të jetë në fuqi deri në përfundim të marrëdhënies kontraktuale me ProCredit Bank dhe detyrimeve që burojnë në kuadër të CRS.

E lëshoj këtë Deklaratë Pëlqimi me vullnet të lirë, dhe me qëllim përpunimin e të dhënave financiare dhe të dhënave personale nga Procredit Bank sh.a, që lidhen dhe burojnë specifikuisht për qëllimin e realizimit të implementimit të CRS, në përputhje me legjislacionin përkatës.

Përmbajtja e kësaj Deklarate Pëlqimi është përpiluar në zbatim dhe në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", si dhe akteve nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të këtij ligji si dhe Udhëzimin e BSH Nr.31, datë 08.05.2002 "Për Sekretin Bankar".

Emri Mbiemri Individit ose Emri i Subjektit

Data: _____

Vendi: _____